



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr. 7112/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 neni 11, 40, Udhëzimit Administrativ 2008/8 neni 6, Rregullores për Organizimin dhe Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Lagjet Urbane neni 4, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 30.10.2012 mori:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE TË FSHATIT

I

Miratohet propozim vendim me numër 02/Nr.7112/2012. për emërimin e komisioni për koordinimin dhe zgjedhjen e këshillave lokale

II

Komisioni përbëhet prej pesë anëtarëve nga të cilët, dy nga Kuvendi i Komunës (një i pozitës dhe një i opozitës), një nga ekzekutivi i komunës, një nga shoqëria civile dhe një përfaqësues i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.

III

Komisioni do të ketë këtë përbërje:

1. Qamush Brava
2. Nadire Mici
3. Fari Kalisi
4. Irfan Qajani dhe
5. përfaqësuesi i fshatit përkatës

IV

Nëpërmjet zyrës për informim të Komunës njofton qytetarët 15 ditë për tubimet e zgjedhjeve të këshillave lokale, me shpalljet publike. Njoftimi duhet të përmbajë: rendin e ditës, datën, kohën dhe vendin e mbajtjes së tubimit.

V

Komisioni do të veproj në harmoni me rregulloren e Kuvendit të Komunës për organizimin, bashkëpunim dhe lagjet urbane

VI

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit

VII

Më këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komisionit, Drejtorja për Administratë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:31.10.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi

